



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE BALLKANIKE

PROGRAMI I LËNDËS

HISTORI E GJUHËS B

Titullari / pedagogu i lëndës: Prof. As. Dr. Adriatik Derjaj
Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore, 20 leksione, 20 seminare
Tipologjia e lëndës: B
Viti akademik/Semestri kur zhvillohet: Viti III/ Semestri II
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Bachelor – Gjuhë, letërsi dhe qytetërim turk
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)
Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës: adritik.derjaj@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Kjo lëndë synon mësimin e historisë së gjuhës turke nëpërmjet elementëve kulturorë dhe gjuhësorë. Lënda është e organizuar në leksione dhe seminare dhe shërben si lëndë për të zhvilluar kompetencat gjuhësore dhe kulturorë të studentëve në gjuhën turke nëpërmjet njohjes me periudha të ndryshme të letërsisë turke, llojet e veprave dhe përfaqësuesit.

Objektivat specifike lëndore: Ky kurs do të identifikojë dhe analizojë në mënyrë të detajuar të gjitha konceptet themelore të tilla si të mësojë për kulturën, për gjuhën dhe për letërsinë turke; të lidhë informacionin gjuhësor të nivelit të mëparshëm gjuhësor me informacionin e ri që mëson për kulturën dhe letërsinë turke

KONCEPTET THEMELORE:

Aftësia për të zhvilluar kompetencën e të shprehurit në gjuhë të huaj, përkatësisht turqisht Kjo lëndë përqendrohet tek fjalia, tek paraqitja e llojeve të saj, tek përshkrimi dhe analiza e strukturave sintaksore të turqishtes nën dritën e metodave të gjuhësisë përshkrimore, ku një vëmendje krejt e veçantë i kushtohet trajtimit të tyre sipas qasjeve dhe zhvillimeve të semantikës bashkëkohore.

Aftësia për të zhvilluar kompetencën e të shprehurit në gjuhë të huaj, përkatësisht turqisht Kjo lëndë përqendrohet tek fjalia, tek paraqitja e llojeve të saj, tek përshkrimi dhe analiza e strukturave sintaksore të turqishtes nën dritën e metodave të gjuhësisë përshkrimore, ku një vëmendje krejt e veçantë i kushtohet trajtimit të tyre sipas qasjeve dhe zhvillimeve të semantikës bashkëkohore.

Aftësia për të shtruar dhe komunikuar me gojë dhe me shkrim problemat teorike. Aftësia për të formuluar dhe vërtetuar hipotezat e studimit si dhe për të nxjerrë rezultate. Kompetenca dixhitale:

Aftësia për të kërkuar dhe administruar informacionin në internet.

Kompetenca shoqërore dhe qytetare: nxitja e punës në grup dhe sensibilizimi për temat sociale.

Kompromisi me etikën si dhe me përgjegjësinë qytetare e profesionale. Kompetenca ndërkulturore: Aftësia për të njohur procese të plurikulturalizmit, ndërkulturalizmit dhe diversitetit kulturor.

Kompetenca për të mësuar se si të mësojme gjate gjithë jetes: Vetëformim i vazhdueshëm.

Aftësia për të zgjedhur tema kërkimore shkencore që mund të ngjallin debate dhe të jenë në interes publik.